

 Republika e Kosovës Republika Kosovo 31 Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-30/2022	Data: Datum: 31.01.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58, pika b të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 49 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/2010), shqyrtoi kërkesën 06Nr19/2022 të datës 31.01.2022 të parashtruar nga Udhëheqësi i Sektorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për lejin e pushimit të lehonisë për Shyhyre Hakaj, nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesën 06Nr19/2022 e datës 31.01.2022 e parashtruar nga Udhëheqësi i Sektorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për lejin e pushimit të lehonisë për Shyhyre Hakaj Infermiere në shtëpinë e të moshuarve në Gurakoc, nga data 12.08.2021 i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.
- Pushimi, i cekur në pikën 1 të këtij Vendimi ka filluar me:12.08.2021 deri më:12.05.2022, e përmendura duhet të lajmërohet në punë me: 12.05.2022
- Në 6 muajt e parë të pushimit të lehonisë prej (12.08.2021 deri me 12.02.2022) paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës dhe 3 muajt në vijim prej (12.02.2022 deri me 12.05.2022) paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë si dhe 3 muaj tjerë pa pagesë mund ti lejohen me kërkesën e të punësuarës.

A r s y e t i m

Udhëheqësi i Sektorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka parashtruar kërkesë 06 Nr19/2022 të datës 31.01.2022 për lejin e pushimit të lehonisë për Shyhyre Hakaj Infermiere në shtëpinë e të moshuarve në Gurakoc.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.

Në pajtim me nenin 49 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010) punëtores i takojnë 6 muaj pushim të lehonisë me pagesë 70% të pagës së marr nga institucioni ku punon, mirëpo nëse donë të kthehet në punë mbas gjashtë muajve është e obliguar që më së voni 15 ditë para përfundimit të pushimit gjashtë muaj të njoftoj: Menaxherin e Personelit se nuk dëshiron të shfrytëzoj pushimin e përcaktuar në kohëzgjatje prej 3 muajve që paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Zyrtari për paga mëditje dhe kompensime obligohet që pas gjashtë muajve të pushimit të lehonisë punëtores e lartpërmendur të qesë në listën e pagave me zero(0) dhe e njëjta pas 9 muajve obligohet të njoftoj institucionin për ndërprerjen e pushimit të lehonisë apo parashtron kërkesë për vazhdimin e pushimit të lehonisë edhe tre muaj pushim pa pagesë.

Për realizimin e pagës në kohëzgjatje prej 3 muajve përmes MPMS-së punëtorja duhet personalisht t'i drejtohet Entit për Punësim për realizimin e kësaj pagese.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Komunës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet: **Shyhyre Hakaj**, Menaxheri i Personelit, Zyrtari financiar për paga mëditje dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
 Z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-25/2022	Data: Datum: 28.01.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 22, paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr.03/L-147 dhe nenin 22, paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën Nr.01-120-2670, të datës 18.01.2022, e parashtruar nga Jakup Blakaj nga fsh. Jabllanicë e Vogël Komuna e Pejës për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së prindit-nënës (**Nushe Blakaj**) i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-120-2670 e datës 18.01.2022 e parashtruar nga Jakup Blakaj, Inspektor i Ndërtimit, për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së nënës (**Nushe Blakaj**) dhe i ndahen mjetet financiare në shumën prej **389.20 €** (treqind e tetëdhjetë e nëntë euro e njëzet cent) nga programi buxhetor i Drejtorisë për Inspekcione, kategoria ekonomike paga dhe mëditje kodi ekonomik 11155-shtesat dhe kompensimet tjera (vendim) si ndihmë për familjen e të lartpërmendurit.
2. Mjetet e cekura në piken 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Jakup Blakaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Inspektion dhe Zyrtarja Financiare për paga mëditje dhe kompensime në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet: **Jakup Blakaj**, Drejtorisë për Inspekcione, Zyrtares Financiare për paga mëditje dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.24/2022	Data: 27.01.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë Komunale për Arsim 05.Nr.32/2022 të datës 27.01.2022, për kompenzimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Engjëll Gegaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Matematikës, në SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 05.Nr.32/2022 e datës 27.01.2022 e parashtruar nga Drejtoria Komunale për Arsim për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Engjëll Gegaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Matematikës, në SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh.
2. Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **05.02.2022**.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime në Drejtorinë Komunale për Arsim, obligohet që Engjëll Gegaj t'ia bëjë pagesën e 3(tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdëset: Drejtoria Komunale për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet: **Engjëll Gegaj**, Drejtorisë Komunale për Arsim, Zyrtarit Financiar për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivën e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-23/2022	Data: Datum: 26.01.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën 08 Nr.11/2022 të datës 26.01.2022 të parashtruar nga Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojte dhe Shpëtim, për caktimin e zyrtarit për shqyrtimin e kërkesave për lëvizjen e lirë të qytetarëve në situatën emergjente me pandemi dhe adresimin e tyre në MPM, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 08 Nr.11/2022 të datës 26.01.2022 e Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojte dhe Shpëtim dhe caktohet: **Blerim Bujupi**-Zyrtar për Ndërtimtari, për shqyrtimin e kërkesave për lëvizjen e lirë të qytetarëve në situatën emergjente me pandemi gjatë kohës se orari të punës dhe pas përfundimit te orarit të punës.
2. Zyrtarit të lartcekur i lejohe ardhja në komunë pas përfundimit të orarit të punës nëse ka kërkesa nga qytetaret në mënyrë elektronike apo thirrje përmes telefonit dhe obligohet të aplikoj në MPM sipas rekomandimit të ISHPK-së për miratimin e lëvizje së lirë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëhere pas nënshkrimit dhe fillon të zbatohet nga Blerim Bujupi-Zyrtar për Ndërtimtari.
4. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi u dërgohet: **Blerim Bujupit**, Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojte dhe Shpëtim, dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-21/2022	Data: Datum: 24.01.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e datës 20.01.2022 të parashtruar nga Fadil Kabashi-Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për formim të Komisionit për dalje në vendin e ngjarjes për vlerësimet e dëmeve të shkaktuara nga erërat në objekte bujqësore, nxjerr:

V E N D I M

- FORMOHET:** Komisioni për dalje në vendin e ngjarjes për vlerësimet e dëmeve të shkaktuara nga erërat në objekte bujqësore dhe në Komision caktohen:
 - Blerim Bujupi**, Zyrtar për Ndërtimtari në DSHPMSh, Kryesues i Komisionit;
 - Valbone Kaliqanaj**, Zyrtare e Lartë për Pemëtari, anëtare dhe;
 - Bajram Sejdiqaj**, Teknik i Gjuetisë, Pylltarisë dhe Peshkimit, anëtar..
- Komisioni i cekura më lartë ka për obligim që të dal në vend ngjarje dhe të bëjë vlerësimin e të gjitha dëmeve të shkaktuara nga erërat në objekte bujqësore; të hartojnë procesverbalin në vendin e ngjarjes dhe të kompletojnë lëndën me dëshmi-foto të dëmeve; të njoftojnë Kryetarin e Komunës me ecurinë e vlerësimit të dëmeve si dhe do t'i kryej punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.
- Komisioni obligohet t'ia filloj punës menjëherë me datën 24.01.2022 si dhe merr përgjegjësi për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga erërat.
- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni.

Vendimi u dërgohet: Komisionit, Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 20 /022	Data: Datum: 24.01.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-3365, të datës 21.01.2022, të parashtruar nga z.Alija Selmanaj nga fsh.Istog i Poshtem, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e tij për dializë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-3365, të datës 21.01.2022, e parashtruar nga z.Alija Selmanaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e tij për dializë dhe i lejohet 57 litra karburant për muaj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që, z.Alija Selmanaj, të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Alija Selmanaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-3365, të datës 21.01.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i tij për dializë. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se z.Alija Selmanaj, është i sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për dializë. I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për dializë. Shefi i autoparkut do të pajisë të përmenduren më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi. Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: z.Alija Selmanaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-19/022	Data: Datum: 24.01.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), neni 10 paragrafi 4 nenin 11 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.13/2019) nenin 21 dhe 26 të Ligjit 05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 31 të Statutit të Komunës së Istogut Nr.62/2010 i datës 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e Zyrtares për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, nxjerr:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike.

1. MIRATOHET: propozimi i Zyrtares për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike është e bazuar kërkesa e datës 19.01.2022 për qasje në dokumente publike e parashtruar nga Eroll Shabani dhe i lejohet qasja e plotë në dokumentet e kërkuara si me poshtë.

- Sa ka qenë numri i kontratave në planin e prokurimit në vitin 2021;
- Sa është numri i kontratave të realizuara brenda vitit 2021;
- Sa është numri i kontratave të filluara në vitin 2021 dhe që vazhdojnë në vitin 2022;
- Sa është numri i kontratave të pa realizuara brenda vitit 2021;
- Sa është numri i aktiviteteve të prokurimit të anuluar në tërësi gjatë vitit 2021;
- Sa është numri i kontratave që kanë përfunduar në OSHP gjatë vitit 2021;
- Sa është numri i kontratave të zgjedhura në OSHP gjatë vitit 2021;
- Sa është numri i kontratave që ende nuk janë zgjedhur;
- Sa aktivitete të prokurimit kanë mbetur të bllokuara nga OSHP gjatë vitit 2021.

2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

3. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Eroll Shabani ka parashtruar kërkesë përmes mënyrës elektronike me datë 19.01.2022 për qasje në dokumente publike.

Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike ka shqyrtuar kërkesën si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës i propozoj Kryetarit të vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryetari e shqyrtoj propozimin e Zyrtares për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe e miraton lejimin e qasjes në dokumente publike si në pikën 1 të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 ditëve nga data e pranimit të tij.

Me kopje të këtij Vendim do të njoftohen: Eroll Shabani, Drejtorja për Administratë Komunale dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-18/022	Data: Datum: 24.01.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), nenin 13 paragrafi 1 i Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.13/2019) dhe nenin 31 të Statutit të Komunës së Istogut Nr.62/2010 i datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

Për caktimin e zyrtarit për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.

- 1. CAKTOHET: znj. Jeta Balaj-Imeraj** e punësuar me titullin e vendit të punës Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.
- 2. Obligohet** Zyrtarja e lartcekur që ti shqyrtoj kërkesat e parashtruar për qasje në dokumente publike pa dallime.
- 3. Detyrat** dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për qasje ne dokumente publike garantohen me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.
- 4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë** pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Jeta Balaj-Imeraj.
- 5. Vendimi është përfundimtar.**

Me kopje të këtij Vendim do të njoftohen: Jeta Balaj-Imeraj, Drejtorja për Administratë Komunale dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-16/2022	Data: Datum: 19.01.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) në nenin 8 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ 10/2014 Punët dhe Kriteret për Vendosjen e Rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare në Shtëpinë me Bazë në Komunitet, shqyrtoj kërkesën 06 nr.09/2022 të datës 17.01.2022 të parashtruar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për formimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për lejimin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, nxjerr:

V E N D I M

1. **THEMELOHET:** Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për lejimin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc dhe në komision caktohen:

1.1. **Valmir Gjoci**, Dr. i Mjekësisë së Përgjithshme, Kryesues i Komisionit;

1.2. **Shëfqet Shatri**, Infermier, anëtar dhe

1.3. **Fisnik Shoshaj**, Zyrtar Ligjor në DSHMS, anëtar.

2. Komisioni i lartcekur cekur do të bëjë shqyrtimin e të gjitha kërkesave për lejimin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc.
3. Personat të cilët plotësojnë kriteret sipas Ligjeve dhe akteve nenëligjore në fuqi, mund t'ju lejohet vendosja në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit).
4. Komisioni obligohet të njoftoj: Kryetarin e Komunës; Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit); Qendrën për Punë Sociale dhe parashtruesin e kërkesës për strehimin apo mos strehimin e personave të moshuar.
5. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevojat të komisionit do t'i kryejë, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni.
7. Vendimi është përfundimtar.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe një kopje të mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-14/2022	Data: Datum: 18.01.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenin 38 të Ligjit Nr.04/L-32 për Arsimin Paruniversitar në Republikën e Kosovës dhe nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të zv.Drejtorit të Institucionit Publik, Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimet dhe Përfundimit të Kontratës dhe Emërimet e Përkohshme, nxjerr:

V E N D I M

- 1. ÇAKTOHET** Ushtrues i Detyrës së drejtorit në SHFMU “Mehmet Akif” në Shushicë **z.Sherif Osmanaj** nga Kaliqani Komuna e Istogut, mësimdhënës në SHFMU “Mehmet Akifi” në Shushicë i kualifikuar në programin e Biologjisë.
- I lartpërmenduri detyrat e drejtorit do ti kryej me kompetencë të plotë në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjorë në fuqi deri në kryerjen e procedurave ligjore për përzgjedhjen e drejtoritë dhe emërimin e tij në këtë institucion arsimor.
- Obligohet Zyrtari i Lartë Financiar i Arsimit përgjegjës për paga të bëjë kërkesën në Departamentin e Pagave në Ministrinë e Financave për vendosjen e të përmendurit në listën e pagave me pagën bazë 495.30 euro, Kodi i titullit DIR-7.8 deri sa të emërohet Drejtori i ri.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: **z.Sherif Osmanaj** dhe Zyrtari i Lartë Financiar i Arsimit.
- Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa pranë Komunës së Istogut.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: **z.Sherif Osmanaj**, SHFMU Drejtoria Komunale e Arsimit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-13/022	Data: Datum: 18.01.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), për caktimin e përcjellësit-shoqëruesit të Kryetarit, nxjerr:

V E N D I M

1. **z.Haki Zeqiraj**, me titull të vendit të punës Zyrtar për Transport 1 në Drejtorinë për Administratë Komunale, caktohet përcjellës-shoqërues i z.Illir Fetatit Kryetar i Komunës.
2. I lartpërmenduri ka për obligim që të shoqëroj gjatë gjithë kohës Kryetarin brenda vendit dhe jashtë vendi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Haki Zeqiraj.
4. Ky vendim është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohet: **Haki Zeqiraj** dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-07/022	Data: Datum: 12.01.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 8 paragrafi 5 nënparagrafi 5.1 nënparagrafi 5.1.3 i Udhëzimit Administrativë (MASHT) 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësit e Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, nxjerr:

V E N D I M

1. **PËR ANULIMIN** e konkursit 05 Nr.678/21 të datës 02.11.2021 për plotësimin e vendit të punës Drejtor në shkollën e mesme të ulët ‘Mehmet Akif’ në Shushicë të shpalluar nga Drejtoria Komunale për Arsim, për shkak të kalimit të afatit për njoftim të Kryetarit të Komunës me rekomandim nga anë e Komisionit .
2. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim.
3. Ky vendim është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Drejtoria për Komunale për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

